

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GJYKATA

Neni 1

Në Ligjin për gjykata ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/2006, 35/2008, 150/10, 83/18 dhe 198/18), në nenin 5 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Para gjykatave mbrohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe të drejtat e subjekteve tjera në Republikën e Maqedonisë."

Neni 2

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Askush nuk është përjashtuar nga procedura para gjyqit, përveç kur me Kushtetutë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën janë përcaktuar raste të imunitetit."

Neni 3

Në nenin 12 në paragrafin (2) fjalët: "më karakteristike" shlyhen, e fjalët: "kriminalitet i fëmijëve zëvendësohen me fjalët: "delikuencë e fëmijëve."

Neni 4

Në nenin 28 paragrafin (1) në pikën 22. fjalët: "Gjykata Themelore Shkupi I Shkup" zëvendësohen me fjalët: "Gjykata Penale Themelore Shkup".

Në pikën 23. fjalët: "Gjykata Themelore Shkupi II Shkup" zëvendësohen me fjalët: "Gjykata Civile Themelore Shkup".

Neni 5

Në nenin 29 paragrafin (1) në pikën 3. fjalët: "Shkupi I - Shkup dhe Shkupi II - Shkup" zëvendësohen me fjalët: "Gjykata Penale Themelore Shkup dhe Gjykata Civile Themelore Shkup".

Neni 6

Në nenin 30 paragrafin (1) alineja 3 shlyhet.

Në paragrafin (2) në alinenë 11 presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 12 shlyhet.

Neni 7

Në nenin 31 paragrafin (1) alineja 2 shlyhet.

Në alinenë 3, e cila bëhet aline 2, pas fjalës "ekstradim" shtohen fjalët: "transferim i personave të gjykuar, njohje dhe përmbarim të vendimeve gjyqësore të huaja".

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse fjalët: "sipas kontesteve civile" zëvendësohen me fjalët: "në punë civile dhe tregtare".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Kompetencën nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni do ta kryejnë gjykatat si vijojnë: Gjykata Themelore në Manastir edhe për njësinë e Gjykatës Themelore në Resnjë; Gjykata Themelore në Prilep edhe për njësinë e Gjykatës Themelore në Krushevë; Gjykata Themelore në Ohër për njësinë e Gjykatës Themelore në Ohër; Gjykata Themelore në Strugë për njësinë e Gjykatës Themelore në Strugë; Gjykata Themelore në Gostivar edhe për njësitë e Gjykatës Themelore në Gostivar, Gjykata Themelore në Kërçovë edhe për njësitë e gjykatave themelore

në Kërçovë dhe Dibër; Gjykata Themelore në Tetovë për njësinë e Gjykatës Themelore në Tetovë; Gjykata Themelore në Kumanovë edhe njësinë e gjykatave themelore në Kriva Pallankë dhe Kratovë; Gjykata Themelore në Koçan edhe për njësinë e gjykatave themelore në Berovë, Vinicë dhe Dellçevë; Gjykata Themelore në Veles për njësinë e Gjykatës Themelore në Veles, Gjykata Themelore në Gjevgjeli për njësinë e Gjykatës Themelore në Gjevgjeli, Gjykata Themelore në Kavadar për njësinë e Gjykatës Themelore në Negotinë; Gjykata Themelore në Strumicë edhe për njësinë e Gjykatës Themelore në Radovish dhe Gjykata Themelore në Shtip edhe për njësinë e Gjykatës Themelore në Sveti Nikollë. "

Neni 8

Në nenin 32 në paragrafin (1) fjalët: "Gjykata Themelore Shkup I - Shkup" zëvendësohen me fjalët: "Gjykata Penale Themelore Shkup".

Në paragrafin (2) fjalët: "Shkupi II Shkup dhe Shtip" zëvendësohen me fjalët: "Shtip dhe Gjykata Civile Themelore", kurse fjalët: "Gjykata Themelore Shkupi II Shkup" zëvendësohen me fjalët: "Gjykata Civile Themelore Shkup".

Në paragrafin (3) fjalët: "gjykata Shkupi I -" zëvendësohen me fjalët: "gjykata penale".

Në paragrafin (4) fjalët: "gjykata Shkupi II-" zëvendësohen me fjalët: "gjykata civile".

Neni 9

Në nenin 34 në paragrafin 1 në alinenë 3 fjalët: "zbatimi dhe përmbarimi i dispozitave" zëvendësohen me fjalët: "procedura për lidhje", kurse kllapat dhe fjalët në kllapa shlyhen.

Në alinenë 4 pas fjalëve: "mbrojtje tjetër juridike dhe" shtohen fjalët: "kundër çdo veprimi administrativ ose lëshimi të veprimit administrativ nëse pala pohon se me atë veprim ose lëshim të veprimit janë cenuar të drejtat apo interesat juridike të saj."

Neni 10

Në nenin 37 paragrafin (1) pas alinesë 6 shtohet aline e re 7, si vijon:

"- miraton kodeks të etikës së gjykatësve për gjykatësit dhe gjykatësit porotë, me propozim të shoqatës së gjykatësve,".

Alineja 7, e cila bëhet aline 8, ndryshohet si vijon:

"- mund të parashtrijë ankesë për ngritje të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës,".

Alineja 8 shlyhet.

Në alinenë 10 fjalët: "zbaton zgjedhje të anëtarëve" zëvendësohet me fjalët: "emëron anëtarë".

Neni 11

Pas nenit 38 shtohet nen i ri 38-a, si vijon:

"Neni 38-a

Gjykatësi i gjykatës themelore me kompetencë të zgjeruar me stazh gjykatësi deri në dy vjet, mund të vendosë vetëm në procedura të nenit 30 të këtij ligji."

Neni 12

Në nenin 39 në paragrafin (8) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje, shtohen fjalët: "por jo më shumë se një herë gjatë pesë vjetëve. Pas kalimit të kohës për të cilën gjykatësi është caktuar në njësi tjetër gjyqësore detyrimisht kthehet në njësinë në të cilën ishte i caktuar paraprakisht."

Në paragrafin (9) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje, dhe shtohen fjalët: “por jo më shumë se një herë gjatë pesë vjetëve. Në rast të dërgimit të përkohshëm, roga e gjykatësit nuk guxon të zvogëlohet. Pas kalimit të kohës për të cilën gjykatësi është dërguar të punojë në gjykatë tjetër ose në njësi tjetër të specializuar detyrimisht kthehet me punë në gjykatë, përkatësisht njësinë e specializuar nga e cila është dërguar.”.

Në paragrafin (10) pas fjalës “Maqedonia” shtohen fjalët: “me vendim të arsyetuar me shkrim”.

Në paragrafin (11) fjalët: “paragrafët (4) dhe (7)”, zëvendësohen me fjalët: “paragrafët (4), (7) dhe (9)”.

Në paragrafin (12) fjalët: “vendimet e paragrafëve (8) dhe “(9)” zëvendësohen me fjalët: “vendimi nga paragrafi (8)”.

Neni 13

Neni 40 ndryshohet si vijon:

"(1) Në rast të pezullimit ose riorganizimit të gjykatës (ndërprerja e njësisë së specializimit ose transferimi i njësisë nga një gjykatë në tjetrën), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë do ta sistemojë gjykatësin e asaj gjykate në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë ose të shkallës më të ulët, me ç'rast roga e gjykatësit nuk guxon të zvogëlohet.

(2) Në rast të sistemimit nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykatësi ka të drejtë kundërshtimi në afat prej tri ditësh në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, e cila është e detyruar të vendosë për kundërshtimin në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i kundërshtimit.”.

Neni 14

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“(1) Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është kompetent për përcaktimin e numrit optimal të gjykatësve ose gjykatësve porotë në gjykatat e Republikës së Maqedonisë.

(2) Numri optimal i gjykatësve dhe gjykatësve porotë në gjykatat në Republikën e Maqedonisë përcaktohet me vendime të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, pas mendimit të marrë nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe mendimit nga seanca e gjykatësve të gjykatës përkatëse, në bazë të analizës dhe projektimit për vende të lira për gjykatës dhe duke zbatuar parimin e përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me Programin vjetor për punë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Vendimet nga paragrafi (2) i këtij neni botohen në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.”.

Neni 15

Në nenin 45 paragrafin (1) në alinenë 3 fjalët: “për çka kryhen kontrole shëndetësore” zëvendësohen me fjalët: “që dëshmohet me vërtetim mjekësor”.

Alineja 4 ndryshohet si vijon:

“-studime juridike të përfunduara me 300 SETK të arritura ose shkallën VII/1 të arsimit nga sfera e shkencave juridike ose diplomë të nostrifikuar nga studime juridike jashtë vendit për 300 kredi të arritura,”.

Në alinenë 6 fjala “aktive” shlyhet.

Pas alinesë 6 shtohet aline e re 7, si vijon:

“- në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër të lidhur me ushtrimin e profesionit juridik ose për vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej së paku gjashtë muajsh,”.

Në paragrafin (2) numri “7” zëvendësohet me numrin “6”.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Llojet e nevojshme të kontroleve shëndetësore, formën dhe përmbajtjen e testit psikologjik dhe testit të integritetit, nivelin e punës praktike me kompjuterë, si dhe afatin e vlefshmërisë së vërtetimeve përkatëse, i rregullon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me akt nëngjyqësor.”.

Neni 16

Neni 46 ndryshohet si vijon:

“(1) Kushte të posaçme për zgjedhje të gjykatësit në gjykatë themelore, gjykatë të apelit dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë janë:

1. gjykatës i gjykatës themelore mund të zgjidhet person i cili e ka përfunduar trajnimin në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë të përcaktuar me ligj;

2. gjykatës i gjykatës themelore mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku katër vjetësh stazh të pandërprerë të gjykatësit si gjykatës në gjykatë tjetër themelore deri në momentin e paraqitjes në zgjedhje, i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

3. gjykatës i gjykatës së apelit mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku gjashtë vitesh stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatën themelore, Gjykatën Administrative ose Gjykatën e Lartë Administrative deri në momentin e paraqitjes në zgjedhje, i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

4. gjykatës i gjykatës së apelit mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku katër vitesh stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatë tjetër të apelit deri në momentin e paraqitjes në zgjedhje, i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

5. gjykatës i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku gjashtë vjet stazh si gjykatës në gjykatën e apelit deri në momentin e paraqitjes në zgjedhje dhe i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(2) Kushte të posaçme për zgjedhje të gjykatësit në Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Lartë Administrative janë:

1. gjykatës i Gjykatës Administrative mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku katër vjetësh stazh të pandërprerë të gjykatësit si gjykatës në gjykatën themelore deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

2. gjykatës i Gjykatës së Lartë Administrative mund të zgjidhet person i cili ka përvojë pune prej së paku gjashtë vjetësh stazh të pandërprerë të gjykatësit si gjykatës në gjykatën e apelit ose në Gjykatën Administrative deri në momentin e paraqitjes për zgjedhje, i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Personi i cili së paku një mandat ka qenë gjykatës në gjykatën ndërkombëtare dhe i cili i plotëson kushtet nga neni 45 i këtij ligji, mund të jetë i zgjedhur për gjykatës në gjykatë nga të gjitha shkallët.”.

Neni 17

Në nenin 47 paragrafët (1) dhe (2), ndryshohen si vijojnë:

"(1) Kryetari i gjykatës zgjidhet nga radhët e gjykatësve të cilët kanë së paku gjashtë vjet stazh të pandërprerë si gjykatës në gjykatë të shkallës së njëjtë ose më të lartë, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj, për kohë prej katër vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes në gjykatë të së njëjtës shkallë.

(2) Kryetar i gjykatës zgjidhet gjykatës i cili nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është vlerësuar me vlerësim pozitiv, në pajtim me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë."

Në paragrafin (3) pas fjalës "gjykatës" shtohen fjalët: "ndërmjet të barabartëve".

Në paragrafin (4) pas fjalës "mandati" shtohen fjalët: "me plan aksionar për zbatimin e programit", presja zëvendësohet me pikë, kurse fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Këshilli Gjyqësor shpall konkurs të ri për zgjedhje të kryetarit të gjykatës në afat prej dhjetë ditësh nga dita kur në mbledhje ka përcaktuar se në konkurs nuk është paraqitur asnjë kandidat ose asnjë nga kandidatët e paraqitur nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për zgjedhje."

Paragrafi (6) bëhet paragraf (7).

Neni 18

Në nenin 52 në paragrafin (1) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "përveç në raste të parapara me ligj."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Gjykatësi mund të mbajë ligjërata në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe në institucion të lartë arsimor dhe të marrë pjesë në projekte shkencore."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Gjykatësi për periudhën derisa ligjëron si ligjërues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, mund ta ushtrojë funksionin e gjykatësit në vëllim të zvogëluar, në pajtim me ligjin."

Paragrafët (5) dhe (6) bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Neni 19

Në nenin 53 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Nëse gjykatësi është emëruar ose zgjedhur anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, gjykatës i gjykatës ndërkombëtare, gjykatës i Gjykatës Kushtetuese, prokuror publik i Republikës së Maqedonisë, drejtor ose zëvendësdrejtor i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, funksioni i gjykatësit i pushon gjatë kohës derisa e ushtron detyrën për të cilën është emëruar përkatësisht zgjedhur. "

Neni 20

Në nenin 56 paragrafin (1) në alinenë 1 pas fjalës "siguri" vendoset pikë, kurse lidhëza "dhe" shlyhet.

Alineja 2 shlyhet.

Neni 21

Neni 63 ndryshohet si vijon:

"Për të drejtat nga nenet 61 dhe 62 të këtij ligji me kërkesë të gjykatësit vendos Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, kurse mjetet sigurohen nga Buxheti Gjyqësor."

Neni 22

Në nenin 67 në paragrafin (2) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: “në pajtim me ligjin dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për largim nga ushtrimi i funksionit të përcaktuara me ligj.”.

Neni 23

Në nenin 68 paragrafin (1) fjalët: “të cilët janë në kundërshtim të kodit etik” shlyhen.

Neni 24

Në nenin 71 në paragrafin (1) pas fjalëve: "Bursë gjyqësore" shtohen fjalët: “nëpërmjet konkursit”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni e miraton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, duke mbajtur llogari për rezultatet nga puna e gjykatësit dhe specializimin e tij në sferën e caktuar.”.

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 25

Titulli i Kapitullit V ndryshohet si vijon:

"V. NDËRPRERJA, SHKARKIMI DHE BAZAT E PËRGJEGJËSISË”.

Neni 26

Në nenin 73 paragrafin (1) alineja 3 ndryshohet si vijon:

“- i ka plotësuar kushtet për pension të moshës, me mundësi për vazhdimin e mandatit në pajtim me dispozitat për marrëdhëniet e punës,”.

Alineja 4 ndryshohet si vijon:

“- paraqiten kushtet nga neni 52 paragrafët (1) dhe (7) të këtij ligji, përveç kur funksioni i gjykatësit pezullohet me kushte të përcaktuara me ligj.”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e konstatimit të ndodhjes së rasteve nga paragrafi (1) i këtij neni, përcakton ndërprerje të funksionit gjyqësor me çka gjykatësit i pushon edhe e drejta e rrogës.”.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Gjykata e cila e ka marrë vendimin e plotfuqishëm nga paragrafi (1) alineja (5) të këtij neni, është i detyruar që menjëherë pas vendimit të plotfuqishëm me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe kryetarin e gjykatës ku gjykatësi e ushtron funksionin.”.

Neni 27

Neni 74 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjykatësi shkarkohet nga funksioni i gjykatësit:

- për shkak të shkëljes më të rëndë disiplinore që e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të përcaktuar me ligj dhe
- për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjykatësit me kushte të përcaktuara me ligj.

(2) Vendim për shkarkimin e gjykatësit miraton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë.

(3) Gjykatësi shkarkohet nga funksioni i gjykatësit në pajtim me bazat e parapara në paragrafin (1) të këtij neni nëse:

- shkelja është kryer me qëllim ose neglizhencë të qartë me faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme dhe

- shkelja ka shkaktuar pasoja të rënda.

(4) Në rast të formës më të lehtë të shkeljes së bazave të paragrafit (1) të këtij neni, gjykatësit mund t'i shqiptohet masë disiplinore.

(5) Në ditën e plotfuqishmërisë së vendimit për shkarkim të gjykatësit nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, sipas bazave nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykatësit i pushon e drejta e rogës.”.

Neni 28

Titujt e neneve 75 dhe 76 dhe nenet 75 dhe 76 ndryshojnë si vijon:

“3. Shkelja më e rëndë disiplinore

Neni 75

(1) Shkelje më e rëndë disiplinore, për të cilën ngrihet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit, llogaritet:

1) shkelje më e rëndë e rendit publik dhe qetësisë dhe forma tjera më serioze të sjelljes së pahijshme me të cilën prishet prestigji i gjykatës dhe prestigji i tij;

2) ndikimi i ashpër dhe përzierja në ushtrimin e funksionit të gjykatësit të gjykatësit tjetër;

3) nëse refuzon të parashtrijë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në pajtim me ligjin ose nëse të dhënat e përmbajtura në deklaratë në masë të madhe janë të pavërteta ose

4) shkelje e qartë e rregullave për përjashtim në situata në të cilat gjykatësi e ka ditur ose duhej ta dijë për ekzistimin e ndonjërs nga bazat për përjashtim të parapara me ligj.

(2) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1) i këtij neni, kryetari i gjykatës në afat prej tetë ditësh nga dita e kuptimit të shkeljes së kryer, por jo më shumë se tre muaj nga shkelja e kryer është i detyruar me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Në rastet e shkeljes disiplinore nga paragrafi (1) pika 1) të këtij neni, kur është miratuar vendimi gjyqësor i plotfuqishëm, gjykata që ka marrë vendimin është e detyruar menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe kryetarin e gjykatës ku gjykatësi e ka ushtruar funksionin gjyqësor.

(4) Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit në rast të paragrafit (1) pikës 1) të këtij neni mund të ngrihet edhe kur është miratuar paraprakisht vendimi gjyqësor i plotfuqishëm.

4. Ushtrimi joprofesional dhe i pandërgjegjshëm i funksionit të gjykatësit

Neni 76

(1) Kryerja joprofesionale dhe e pandërgjegjshme e funksionit të gjykatësit nënkupton profesionalizëm të pamjaftueshëm ose papërgjegjësi të gjykatësit që ndikon në kualitetin dhe azhurnimin në punë, edhe atë nëse:

1) në dy vlerësime të njëpasnjëshme nuk i plotëson kriteret për sukses në punë, për fajin e gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme, për çka është vlerësuar me dy vlerësime negative, kurse në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

2) është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të dënimit më të ulët nga ai i paraparë në nenin 73 paragrafin (1) alinenë 5 të këtij ligji, kurse i cili është rezultat i drejtpërdrejtë i veprimit në kryerjen e funksionit gjyqësor, qëllimisht ose me neglizhencë të vetëdijshme;

3) jep informata të klasifikuara në mënyrë të paautorizuar, përkatësisht jep informata dhe të dhëna për lëndë gjyqësore me çka shkelet detyrimi për mbrojtjen e fshehtësisë së procedurës së përcaktuar me ligj dhe kur publiku është i përjashtuar në pajtim me ligjin;

4) pa shkaqe të arsyeshme nuk i cakton seancat në lëndët të cilat i janë ndarë në punë ose në mënyrë tjetër e zvarrit procedurën;

5) nuk e merr lëndën në punë për ç'shkak fillon vjetërsimi i ndjekjes penale ose vjetërsimi i ekzekutimit të sanksionit penal për vepër penale;

6) merr në punë lëndë e cila nuk i është ndarë nëpërmjet sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore në gjykata;

7) qëllimisht dhe pa arsye bën gabim të madh profesional, me çka interpretimi i ndryshëm i të drejtës dhe fakteve nuk mund të paraqesë bazë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit.

(2) Për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kryetari i gjykatës në afat prej tetë ditësh nga dita e kuptimit të shkeljes së kryer, por jo më shumë se gjashtë muaj nga shkelja e kryer është i detyruar që me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1) pika 2) të këtij neni gjykata që e ka marrë vendimin e plotfuqishëm është e detyruar që menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe kryetarin e gjykatës ku gjykatësi e kryen funksionin gjyqësor. ".

Neni 29

Neni 77 ndryshohet si vijon:

“(1) Shkelje disiplinore për të cilën ngrihet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së gjykatësit për të cilën do të shqiptohet masë disiplinore konsiderohet:

1) shkelja më e lehtë e rendit publik dhe qetësisë ose forma tjetër më e lehtë e sjelljes së pahijshme me të cilën prishet prestigji i gjykatës dhe prestigji i tij;

2) shfrytëzimi i funksionit të vet dhe prestigjit të gjykatës për realizimin e interesave të veta private;

3) mosplotësimi i detyrimeve të mentorit;

4) shkelja e rregullave për mungesë nga puna;

5) mosndjekja e trajnimeve të detyrueshme ose

6) mosmbajtja e togës gjyqësore gjatë kohës së gjykimeve.

(2) Për shkeljen disiplinore nga paragrafi (1) i këtij neni, kryetari i gjykatës është i detyruar që në afat prej tetë ditësh nga dita e kuptimit për shkeljen e kryer, por jo më shumë se gjashtë muaj nga shkelja e kryer, me shkrim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

(3) Masa disiplinore i shqiptohet gjykatësit në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni nëse:

- shkelja disiplinore është kryer me qëllim ose neglizhencë të dukshme me faj të gjykatësit pa shkaqe të arsyeshme dhe

- shkelja disiplinore ka shkaktuar pasoja të rënda.”.

Neni 30

Neni 78 ndryshohet si vijon:

“(1) Për përgjegjësi të përcaktuar të gjykatësit, Këshilli mund të shqiptojë një nga këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim

- qortim publik,

- zvogëlim i rogës në lartësi prej 15% deri në 30% nga roga mujore e gjykatësit në kohëzgjatje nga një deri më gjashtë muaj.

(2) Nëse gjykatësit me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar masë disiplinore zvogëlim i rogës në lartësi prej 15% deri më 30% të rogës mujore, gjykatësi nuk mund të zgjidhet në gjykatë më të lartë, si anëtar i Këshillit Gjyqësor, i propozuar si gjykatës në gjykatën ndërkombëtare, drejtor ose zëvendës drejtor i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, për kohën derisa zgjat masa disiplinore.

(3) Gjatë përcaktimit të masës disiplinore, përcaktimit dhe shqiptimit të masave disiplinore detyrimisht merren parasysh pesha e shkeljes, shkalla e përgjegjësisë, rrethanat nën të cilat është kryer shkelja dhe sjellja e gjykatësit, pasojat e shkeljes së kryer si dhe masat disiplinore të shqiptuara paraprakisht."

Neni 31

Në nenin 79 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

“-tejkallim dhe shkelje e autorizimeve ligjore,”.

Alinetë 3, 5, shlyhen.

Alineja 7, e cila bëhet aline 5, ndryshohet si vijon:

“shkelje e dispozitave për miratimin dhe ndryshim të Orarit vjetor të gjykatësve,”.

Alinetë 8 dhe 9 shlyhen.

Alineja 10, e cila bëhet aline 6 ndryshohet si vijon:

“-nëse kryetari i gjykatës nuk e njofton Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për shkeljen disiplinore më të rëndë të kryer nga nenet 75, 76 dhe 77 të këtij ligji nga gjykatësi në gjykatën në të cilën është kryetar, nëse kryerjen e shkeljes e ka pasur të njohur, kurse mosparaqitja është për shkak të mbulimit të saj,”.

Alineja 12 shlyhet.

Neni 32

Pas nenit 87 shtohet neni i ri 87-a, si vijon:

“Neni 87- a

(1) Themelohet Këshilli për Koordinimin e Teknologjive Informatike-Komunikuesve në organet e jurisprudencës (në tekstin e mëtejme: Këshilli i TIK-ut) si trup operativ profesional i përbërë nga përfaqësuesit e organeve të jurisprudencës.

(2) Këshilli i TIK-ut jep propozim për përcaktimin e prioriteteve të politikave dhe koordinim të organeve të jurisprudencës në punën e sistemit të teknologjisë informatike-komunikuese.

(3) Ministria e Drejtësisë jep mbështetje administrative-teknike të punës së Këshillit të TIK-ut.

(4) Ministria e Drejtësisë është shfrytëzuese e të dhënave statistikore në bazat e të dhënave të sistemit informatik në jurisprudencë.

(5) Ministri i Drejtësisë me akt nënligjor e përcakton përbërjen dhe mënyrën e punës së Këshillit të TIK-ut.

(6) Anëtarëve të Këshillit të TIK-ut u takon kompensim mujor me para në shumë prej një të tretës së rogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka ministri i Drejtësisë miraton aktvendim.”.

Neni 33

Në nenin 98 në paragrafin (1) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “si dhe bëhet pranim i parashtrimeve me shkrim.”.

Neni 34

Në nenin 99 në paragrafin (1) pas fjalës “lëndë” vendoset presje dhe shtohen fjalët: “portali gjyqësor”.

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

“(2) Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë është përgjegjës për funksionimin e sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndët gjyqësore në gjykata.

(3) Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë formohet trup punues për standardizimin e procedurave gjatë shfrytëzimit të sistemit kompjuterik të automatizuar për menaxhim me lëndë gjyqësore në gjykatat në përbërje nga një gjykatës i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, një gjykatës nga çdo Gjykatë e Apelit, një gjykatës nga Gjykata Administrative, një gjykatës nga Gjykata e Lartë Administrative, një gjykatës nga gjykata themelore, administrator në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe tre informaticienë nga gjykatat. ”.

Paragrafi (2) bëhet paragraf (4).

Paragrafi (3), i cili bëhet paragraf (5), ndryshohet si vijon:

“(5) Vendimet e plotfuqishme të miratuara gjykatat detyrimisht i publikojnë në ueb faqen e gjykatës në afat prej shtatë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë, në mënyrë të përcaktuar me ligj.”.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Paragrafi (6) shlyhet.

Paragrafi (7), i cili bëhet paragraf (8), ndryshohet si vijon:

“(9) Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, me akt nënligjor, e përcakton mënyrën e funksionimit të sistemit informatik në të gjitha gjykatat, me pëlqimin paraprak nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.”.

Neni 35

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen, përkatësisht harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë do ta miratojë kodin etik gjyqësor për gjykatës dhe gjykatës porotë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e kodit etik të gjykatësit për gjykatës dhe gjykatës porotë nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë zbatohet Kodi etik i miratuar nga Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë dhe ai është i detyrueshëm për të gjithë gjykatësit në Republikën e Maqedonisë.

Neni 36

Trupi punues për standardizimin e procedurave në gjykata nga neni 34 i këtij ligji do të formohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Organet e jurisprudencës do t'i caktojnë përfaqësuesit e vet në Këshillin e TIK-ut në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të dispozitës nga neni 87-a paragrafi 5 të këtij ligji, kurse mbledhja konstitutive e Këshillit të TIK-ut do të mbahet në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të dispozitës nga neni 87-a paragrafi 5 të këtij ligji.

Neni 37

Procedurat e filluara për lëndët e ndara në punën e gjykatësit të gjykatës themelore me kompetencë të zgjeruar me stazh të gjykatësit më pak se dy vjet, do të përfundojnë para gjykatësit të njëjtë.

Neni 38

Gjykatat themelore në Gjevgjeli, Kavadar dhe Kërçovë do t'i kryejnë kompetencat e gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar nga 1 janari 2020.

Procedurat gjyqësore të filluara para 1 janarit 2020, dhe të cilat pas marrjes së statusit të gjykatave me kompetencë të zgjeruar të gjykatave në Gjevgjeli, Kavadar dhe Kërçovë do t'u takonin atyre, vazhdojnë para gjykatës para të cilës kanë filluar.

Neni 39

Gjykatësit të cilët sipas Ligjit për gjykata (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006, 35/2008, 150/10, 83/18 dhe 198/18), në vitin 2019, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t’i plotësojnë kushtet për pension të pleqërisë gjegjësisht do t’i mbushin 64 vjet pleqëri, kanë të drejtë të parashtrojnë deklaratë me shkrim për zgjatjen e mandatit, sipas dispozitave të nenit 26 paragrafi 1 këtij ligji, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.